
E DREJTA E GRAVE PËR TRASHËGIM NË PRONË

"Ky raport u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbytja është përgjegjësi e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara".

AUTOR:

Rron Gjinovci

REDAKTORE:

Kreshnik Gashi

MONITORUES/GAZETARË:

Adelina Ahmeti

Paulina Nushi

Qëndresa Mustafa

Petrit Kryeziu

Naim Krasniqi

Qazim Hasanaj

Lekë Muqaj

Armend Zenelaj

Behar Mustafa

Labinot Leposhtica

Skender Govori

Taulant Rracaj

Liridon Rama

Publikuar nga:



© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Prishtinë, Korrik 2016.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti pa leje paraprake. Kontaktoni me zyrën administrative të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese për kërkesa të tilla.

E DREJTA E GRAVE PËR TRASHËGIM NË PRONË

Korrik 2016

Përmbajtja

05 HYRJE

06 METODOLOGJIA

07 E DREJTA E TRASHËGIMIT

Të drejtat e garantuara në Kushtetutë

E drejta e trashëgimit e paraparë në ligj

Rastet e përjashtimit të trashëgimtarëve femra

09 E DREJTA ZAKONORE NË NDARJEN E TRASHËGIMIT PËR GRATË

Ndikimet e Kanunit në mentalitetin e sotëm të popullsisë

Zakonet lidhur me Gratë dhe Trashëgimin te Minoritetet

E përbashkëta e komuniteteve lidhur me trashëgimin e grave

12 TRADITA ISLAME NË NDARJEN TRASHËGIMIT PËR GRATË

Dy raste të mundshme

14 PAQARTËSI DHE PROBLEME INSTITUCIONALE

Ministria e Drejtësisë në punë e sipër të amandamentimeve

Kohëgjatësia e procedurave si pengesë për realizim simbolik të së drejtës

16 KRAHASIM I SHKURTËR I KORNIZAVE LIGJORE KOSOVË-SHQIPËRI-MAQEDONI

Cili institucion e kryen ndarjen e trashëgimit?

Cili është rendi i trashëgimtarëve?

Si trashëgohet?

A lejohet heqja dorë nga trashëgimi?

17 KRAHASIM I SHKURTËR I KORNIZAVE LIGJORE KROACI-SLLOVENI-KOSOVË

Cili institucion e kryen ndarjen e trashëgimit?

Cili është rendi i trashëgimtarëve?

Si trashëgohet?

A lejohet heqja dorë nga trashëgimi?

18 RASTI I SHYHRETE BERISHËS

A trashëgojnë personat që bashkëjetojnë në bashkësinë jashtmartesore?

20 KONKLUDIME

21 REKOMANDIME

Lidhur me kornizën ligjore

Lidhur me emancipimin shoqëror

22 REFERENCA

Hyrje

Kjo analizë është kryer me qëllim të paraqitjes së një pasqyre të problemeve kryesore të realizimit të së drejtës së trashëgimit nga gratë. Sipas të dhënave të deritanishme në Kosovë vetëm 16% (shih tabelën 1) e pasurisë së paluajtshme është e regjistruar në pronësi të grave¹.


Në Kosovë të drejtat e barabarta të grave në përgjithësi, dhe në trashëgimi në veçanti, janë garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Trashëgiminë, Ligjin për Procedurën Jo kontestimore dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Megjithë ekzistencën e një kornize ligjore, tradita popullore e ndarjes së pasurisë që bazohet në të drejtën zakonore, siç është Kanuni i Lekë Dukagjinit apo rrallëherë dhe të së drejtës së trashëgimit sipas shariatit në të drejtën islame, ka marrë terrenin kryesor në ndarjen e trashëgimit mes trashëgimtarëve në Kosovë. Hapësira që krijon ligji duke mundësuar marrëveshjen e palëve dhe mundësinë e heqjes dorë nga trashëgimia, bëjnë që palët të “merren vesh” mes vete, sipas rregullave kanunore apo rregullave të tjera të ngjashme me traditat patriarkale në Kosovë.

Po ashtu, ky hulumtim përfshin krahasime të shkurtra por që rezultojnë në rekomandime konkrete me kornizat ligjore të vendeve fqinje si Shqipëria e Maqedonia dhe po ashtu, me vendet që dikur Kosova ka ndarë një frymë kushtetuese (gjatë periudhës jugosllave) por që tashmë janë pjesë e Bashkimit Evropian ku Kosova aspiron anëtarësimin, Kroacisë dhe Sllovenisë.

Ky publikim vjen edhe me rekomandimet konkrete për ndërhyrjet që duhen bërë me qëllim të përmirësimit të situatës për sa i përket rritjes së kërkuesve të trashëgimit nga trashëgimtarët femra dhe realizimit të së drejtës së tyre në të ardhmen e afërt.

Tabela 1. – përqindja e pronave të regjistruara në emër të grave në shtetet që kufizohen me Kosovën



¹ Projekti për Pronën e Paluajtshme dhe Kadastër - RECAP, Kënaqshmëria Vjetore e Konsumatorit - Faza e Dytë <http://www.kca-ks.org/documents/10179/319567/ang.pdf/3f4bf6ff-7ba4-46ee-8d17-b0e0cb3d7a2d>

Metodologjia

Hulumtimet për këtë analizë janë bërë me metodologji kualitative të hulumtimit.

Fillimisht janë shqyrtuar raportet e deritanishme të publikuara në Kosovë në gjuhën shqipe dhe angleze (deri më 1 prill 2016). Raportet që kanë shërbyer për shqyrtim do të përmenden gjatë elaborimit të temave dhe nëntemave të ngritura në këtë analizë. Pjesë e këtyre shqyrtimeve janë edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit si mënyrë e rregullimit tradicional të çështjes së trashëgimit në pronë, si dhe E Drejta Trashëgimore Islame, duke pasur parasysh që një pjesë e popullsisë së Kosovës ushtron në përditshmëri islamin jo vetëm si besim, por në një sërë aspektesh edhe si mënyrë jetese.

Janë shqyrtuar edhe artikuj të ndryshëm gazetaresk ku janë raportuar raste të shkeljes së të drejtave të trashëgimit në pronë të grave.

Gjithashtu, janë zhvilluar intervista me gjykatës të procedurës jokontestimore dhe kontestimore, me noterë, me ekspertë të së drejtës së trashëgimit në Bashkësinë Islame të Kosovës, me gra aktiviste që punojnë aktualisht në vetëdijësimin e grave për ta kërkuar trashëgimin dhe me gazetarë që kanë punuar në rastet e ndërlidhura me këtë analizë.

Një takim i posaçëm është mbajtur me akterë ku kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile të Kosovës të përfshirë në çështjen e ngritur në këtë publikim, gjykatës, avokatë dhe gazetarë që kanë punuar në raste të ngjashme.

Në total janë intervistuar dhe kontaktuar zyrtarisht 66 persona nga institucione relevante, në mënyrë personale dhe grupe të profesioneve dhe fushave të përmendura më lart. Për bazë janë marrë edhe artikujt, emisionet e intervistat të realizuara nga BIRN. Emisionet, artikujt dhe intervistat e publikuara kanë përfshirë gjyqtarë, avokatë, noterë, zyrtarë komunalë, pleqnarë, pedagogë, profesorë, përfaqësues të shoqërisë civile, deputetë, etj.

Krahasimi mes të drejtës zakonore kombëtare dhe asaj religjioze janë përfshirë në këtë analizë, ashtu si edhe krahasimi mes kornizës ligjore të Kosovës me Maqedoninë dhe Shqipërinë si vende fqinje; po ashtu me Kroacinë dhe Slloveninë si vende të BE-së por me të kaluar të përbashkët të organizimit shoqëror e shtetëror gjatë periudhës jugosllave.

E drejta e trashëgimit

E drejta e trashëgimit në Kosovë është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Megjithatë, një pjesë e popullsisë së Kosovës ka funksionuar duke ndjekur traditën, që nënkupton ndarjen e pasurisë në mënyrë verbale nga kryefamiljari (trashëgimlënësi), jo duke u bazuar në parimin e barazisë, por në vullnetin e lirë të trashëgimlënësit, apo në rastet kur trashëgimia nuk është ndarë nga trashëgimlënësi ajo është ndarë mes trashëgimtarëve meshkuj duke mos i përfshirë trashëgimtarët femra. Gjithashtu, një mënyrë e mundshme e ndarjes së trashëgimit është ajo e përcaktuar sipas Të Drejtës Islame, e cila përfshin edhe trashëgimtarët femra në dispozitat e saj.

Të drejtat e garantuara në Kushtetutë

Kushtetuta e Kosovës e ka përcaktuar si të barabartë rolin e grave dhe burrave në shoqëri dhe e ka parandaluar diskriminimin duke e sanksionuar këtë me nene të veçanta apo me përvetësimin e konventave ndërkombëtare të përmendura në të.

Neni 7, pika 2, flet drejtpërdrejt për barazinë gjinore si vlerë themelore e demokracisë në Kosovë.

“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore.”²

Po ashtu, në Nenin 22, duke marrë përsipër garantimin e të drejtave sipas konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare, Kushtetuta përmend Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Gruas.

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen në këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve tjera dhe akteve tjera të institucioneve publike.”³

Nga kjo mund të thuhet se mundësia që ndonjë ligj apo akt tjetër institucional të shkaktojë shkelje të të drejtave apo të ushtrojë diskriminim të paraparë në konventat e renditura, është përjashtuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

E drejta e trashëgimit e paraparë në ligj

Ligji për Trashëgiminë e përcakton trashëgimin si proces që fillon me vdekjen e personit fizik të përcaktuar në Nenin 4, paragraf 1.⁴

2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

3 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

4 Neni 4.1. i ligjit të trashëgimisë “Trashëgohet për shkak të vdekjes dhe në momentin e vdekjes së personit fizik” http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_26_al.pdf

Ky ligj e përcakton ndarjen e trashëgimit mes anëtarëve të familjes pa përjashtuar trashëgimtarë në baza gjinore në Nenin 3 paragrafi 1.⁵

Trashëgimtarët prioritarë sipas rendit të përcaktuar me Ligjin për Trashëgiminë janë bashkëshortët dhe fëmijët e trashëgimlënësit. Në këtë kontekst bashkëshortja (qoftë edhe jashtëmartesore me përmbushjen e plotësimit të prezumimit të martesës) dhe vajzat e trashëgimlënësit konsiderohen si trashëgimtarë të radhës së parë të trashëgimisë të barabarta me trashëgimtarët e tjerë të kësaj radhe.

Po ashtu, Ligji për Trashëgiminë në Kosovë ka paraparë mundësinë e heqjes dorë nga trashëgimia në kapitullin II të Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë në nenin 130, pika 1 ku thuhet: “130.1.Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin”, gjë e cila ndodh shumë shpesh në praktikë nga ana e grave - kanë konstatuar të intervistuarit e këtij hulumtimi.

Rastet e përjashtimit të trashëgimtarëve femra

Një pjesë e të intervistuarve të BIRN kanë përmendur raste kur trashëgimtarët meshkuj nuk i paraqesin trashëgimtarët femra gjatë përpilimit të dëshmisë mbi vdekjen. Megjithatë, më parë është raportuar edhe për raste kur trashëgimtarët meshkuj janë fshehur nga trashëgimia.⁶

Gjykatësit dhe noterët e intervistuar nga BIRN lidhur me këtë hulumtim specifik thonë se nuk kanë pasur në përvojën e tyre raste kur familjet janë munduar t'i fshehin trashëgimtarët.

“Gjatë përvojës sime nuk ka pasur asnjë rast të tentim fshehjes së trashëgimtarëve [femra], pasi kjo do të bënte që të inicoja rast tjetër me konsekuenca penale për fshehësit” – tha Drita Rexhaj, gjykatëse e procedurës jokontestimore në Prishtinë e intervistuar nga BIRN.

Ngjashëm është shprehur edhe noteri Fatmir Halimi nga Gjilani, i cili ka thënë “Në zyrën time dhe sipas informacioneve që kemi nga Oda e Noterve [e Kosovës], nuk kemi ndonjë njohuri se deri më sot ka ndonjë lëndë gjyqësore (civile apo penale) lidhur me këtë çështje.”

Po ashtu, zyrtarja e Gjykatës Supreme të Kosovës, Antigona Uka, në një komunikim zyrtar më 7 qershor 2016 konfirmoi se “Gjykata Supreme nuk ka pasur ndonjë ankesë në këtë drejtim.”

Megjithatë, dëshmia mbi vdekjen është dokument i cili parashihet të jepet nga komuna. Në këtë dëshmi përveç të dhënave personale për personin e vdekur, gjenden edhe trashëgimtarët e mundshëm të tij/saj. Këtë dëshmi gjykatat mund ta përpilojnë edhe vetë duke nxjerrë vendim në të cilin konfirmohet vdekja e trashëgimlënësit.

Por në shumë raste, rezulton se qytetarët nuk paraqiten në komunë për ta regjistruar vdekjen e të afërmit, një procedurë që kërkon praninë e të gjithë familjes me certifikatat përkatëse.

Drita Rexhaj, gjykatëse që merret me rastet e procedurës jokontestimore në Prishtinë e intervistuar më 30 mars 2016 ka pohuar se asnjëherë nuk ka marrë dëshmi mbi vdekjen nga komuna. Sipas gjykatëses së intervistuar, është dashur që në të gjitha rastet të bëhet vendim mbi vdekjen në bazë të dëshmive të sjella nga palët në proces gjyqësor.

5 “Të gjithë personat fizikë në kushte të njehta janë të barabartë në trashëgimi.”

6 Emisioni “Falsifikimi i trashëgimisë” i transmetuar në “Drejtësia në Kosovë” më 10 shkurt 2013 - <https://www.youtube.com/watch?v=881nya1Kv8U>

Rexhaj ka shpjeguar se duhet pasur kujdes me dëshmitarët, dhe tregon se kur pyeten njerëzit në moshë lidhur me fëmijët e tyre, ekziston një tendencë që ata të deklarojnë vetëm djemtë. “Për shembull kur është dëshmitare ndonjë grua në moshë dhe e pyes për numrin e fëmijëve, nëse ajo ka 2 djem dhe 3 vajza, ajo përgjigjet se ka vetëm dy fëmijë. Pasi e përsëris duke e qartësuar se e kam fjalën edhe për vajzat, ajo i konfirmon ato” – shpjegoi Rexhaj.

Nëse caktimi i trashëgimtarëve do të bëhej me automatizëm përmes çertifikatave të vdekjes atëherë mundësia për fshehje të trashëgimtarëve do të ulej.

Verifikimi i të dhënave në mënyrë që të përpilohet një dëshmi e vdekjes merr shumë kohë dhe zgjat procedurat. Fjala është për seancat kur sillen dëshmitë dhe mundësinë që gjykatësi të kërkojë më shumë të dhëna, çka mund të marrë më shumë kohë me disa senaca. Kjo mund t'i dekurajojë palët për të vazhduar me gjykimin.

E drejta zakonore në ndarjen e trashëgimit për gratë

Duke pasur parasysh se vetëm 16% e pronarëve të pronave të regjistruara në Kosovë janë gra, shihet që zbatueshmëria e Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk është as afërsisht e realizuar.

Për të kuptuar arsyet duhen parë dispozitat bazë të Kanunit të Lekë Dukagjinit që konsiderohet përcaktues i frymës së zakoneve tradicionale shqiptare në Kosovë.

Kanuni përcakton në mënyrë negative rolin e gruas në trashëgim duke mohuar të drejtën e saj në trashëgim si nga ana e bashkëshortit ashtu edhe e familjes së origjinës:

“NYE I NJIZETËT. Trashigimi i grues Shqyptare.

Grueja shqyptare farë trashigimit s’ka te prindja, as më plang, as në shpi, - kanuja e xen gruen si nji tepricë në shpi. Prindja s’mendon per pajë as per kurrnji send per vajzë të vet; qi e xen do t’i a baje kujdesin. Prindja e djalit, qi e xun vajzen do të mendojn per gjith shka duhet per martesë të saj.”⁷

Duke cilësuar gruan si “tepricë” në shtëpi Kanuni i jep vetëm të drejtat në ditën e martesës që lidhen me përmbushjen e zakoneve të ceremonisë së martesës.

7 Kanuni i Lekë Dukagjinit

Ndikimet e Kanunit në mentalitetin e sotëm të popullsisë

Gjatë intervistimit të grave mund të vërehet përbrendësimi i dispozitave kanunore në mënyrën e të menduarit nga to, sidomos kur ato shprehen rreth ushtrimit të së drejtës së tyre për trashëgim të pronës nga familja e origjinës. Si ato gra që flasin për arsyet e ushtrimit të kësaj të drejte, si ato që flasin për heqjen dorë nga kjo e drejtë, gjatë shpjegimeve që japin lidhur me trashëgimin përdorin shprehjen “marr nga vëllau”. Pra, ato konsiderojnë se pjesa e tyre e trashëgimisë, ndonëse mund t’u takojë sipas ligjit është diçka që merret nga anëtarët meshkuj të familjes, e si rrjedhim heqjen dorë nuk e shohin si dhurim të pjesës së tyre të trashëgimit.

Një nga pjesëmarrëset e fokus grupit⁸ të mbajtur në Prishtinë më 24 mars 2016, e punësuar, me shkollim universitar, duke shpjeguar pse mendon të heqë dorë nga trashëgimia mundohet të sqarojë arsyet e marrjes së këtij vendimi. Ajo e quan emocional vendimin e saj dhe është e vetëdijshme për këtë, por insiston se tokën të cilën e ka lënë i ati ajo nuk arrin ta shohë si diçka të ndashme. Për të toka ka një vlerë simbolike që shënon familjen e saj. Po ashtu, duke qenë motra e madhe, ajo konstaton se këtë vendim e ndikon ndjenja e të qenit kujdestare ndaj vëllait të vogël.

Duke qenë se ajo vetë tani ka “shkuar në derë të huaj”⁹ ajo nuk e konsideron marrjen e pronës së familjes së saj të origjinës.

Pjesëmarrësja tjetër e fokus grupit të mbajtur më 24 mars 2016, punonjëse në institucione komunale, me shkollim universitar, jep shpjegime politike për atë se pse kjo e drejtë nuk është ushtruar para vitit 1999 dhe pse duhet ushtruar tash. Ajo e sheh periudhën e para vitit 1999 si një periudhë bashkimi e solidariteti dhe kërkesën për ndarje të trashëgimit si diçka në kundërshtim me këtë frymë, mirëpo arsyeton se kërkesa për ndarje të trashëgimit tash është legjitime.

Të intervistuarat e fokus grupit të mbajtur në Prishtinë më 24 mars 2016, kanë konstatuar se ushtrimi i së drejtës së trashëgimit acaron marrëdhëniet me trashëgimtarët meshkuj të familjes së origjinës dhe në shumicën e rasteve marrëdhënia mund të këputet e tëra. Kjo situatë lidhet me një pjesë tjetër të Kanunit. Përrjashtimi i grave nga familja në raste të cënimit të nderit të familjes apo të bashkëshortit është diçka që u garantohet anëtarëve meshkuj të familjes dhe konsiderohet si një nga rrethanat më të rënda të turpërimit të familjes.

Zakonet lidhur me gratë dhe trashëgimin te komunitetet tjera

Komunat me shumicë nga komunitetet tjera nuk qëndrojnë më mirë në regjistrimin e pronave në emër të grave. BIRN ka bërë një krahasim të komunës me shumicë serbe të Klllokotit me komunën e saj fqinje me shumicë shqiptare të Vitisë.

Të dhënat e siguruara nga KALLXO.com tregojnë se vetëm 1.8 për qind e pronës së Klllokotit është në emër të grave. Situata nuk është e përafërt por as e lavdërueshme në Komunën e Vitisë ku vetëm 14% e pronës është e regjistruar si pronë e grave.

⁸ Fokus grupi është mbajtur më 24 mars 2016, në Prishtinë në hapësirat e Institutit Kombëtar Demokratik - NDI. Në këtë fokus grup kanë marrë pjesë: Besa Veseli – Zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Mitrovicës; Drita Milaku – asambliste në Komunën e Prizrenit; Majlinda Ortogllava – asambliste në Komunën e Vushtrrisë; Nita Lusha – SOS fshati Prishtinë; Shpresa Veliqi – asambliste në Komunën e Skënderajt; Violeta Berisha – zyrtare e Departamentit për Integrim në MPB; Xhevrije Peci – këshilltare për persona me aftësi të kufizuar në Prishtinë.

⁹ Me këtë shprehje shënohet martesë e vajzave. Duke qenë se Kanuni i sheh si tepëri në shtëpi, dalja e tyre prej shtëpisë, përmes martesës i bënë ato pjesë të një fisi tjetër. Rrjedhimisht, marrja e pronave të familja e origjinës do të konsiderohej si ndërhyrje në fisin e origjinës.

E intervistuarja Sanja Sovrllic, e cila punon si gazetare për radio “Mir” (shqip: Paqja) më datë 22 qershor 2016, ka sqaruar se situata nuk ndryshon sa i përket komunitetit serb. Ajo ka dhënë detaje se si mentaliteti patriarkal është i ngulitur edhe në kulturën e komunitetit serb që jeton në Kosovë duke sqaruar situatën e saj personale. “Gjyshja ime ka treguar se si nuk janë gëzuar edhe aq që kam lindur unë. Kur kam pyetur pse, përgjigja nga gjyshja ka qenë “të gjithë, gjyshi, babai kanë qenë fëmijë të vetëm edhe vëllai yt do të jenë vetëm. Mirëpo ata të gjithë kanë pasur motra ashtu siç edhe vëllai im më ka mua” – tregoi Sovrllic për BIRN. Mentaliteti i grave të etnisë serbe në Kosovë rezultoi i ngjashëm me ato të etnisë shqiptare kur fjala vjen te marrja e pasurisë sipas ligjit, duke ua lënë meshkujve të afërt rendin e trashëgimisë. “Ne mogu da uzmemo to svom bratu, Ne mogu da uradim to svom bratu” (Nuk mund t’ia marr atë vëllait tim. Nuk mund t’ia bëj atë vëllait tim). – janë shprehjet të cilat dëgohen më së shpeshti, sipas Sovrllic

Nga OJQ “Gruaja Hyjnore” me seli në Gjilan e cila trajton gratë e komuniteti turk kanë dhënë arsye të ngjashme për mungesën e ushtrimit të së drejtës në trashëgim nga gratë.

Një problem edhe për gratë e komunitetit turk mbetet njohuria mbi të drejtat. “Një pjesë e madhe e femrave (nga qyteti dhe shumica nga rrethina) nuk janë të njoftuara që atyre iu takon me ligj e drejta e trashëgimit si për vajza ashtu edhe për djem” – ka thënë Qëndresa Hajdari nga “Gruaja Hyjnore”, 22 qershor 2016.

Ngjashëm Sovrllic nga Leposaviqi thotë se “Gratë në fshatra kanë probleme të mëdha. Më duket se as që ekziston si opcion marrja e trashëgimit”.

Qëndresa Hajdari nga OJQ “Gruaja Hyjnore” ka thënë se presioni vjen edhe nga familjet në rast se gratë vendosin ta ushtrojnë të drejtën e tyre për trashëgim. “Ato që janë në dijeni për këtë ligj, prap kanë presion nga familja me atë se nëse vajzat e marrin trashëgimin nga vëllau, atëherë ato nuk kanë se pse të vijnë më në atë shtëpi (të prindërve, apo vëllait si i thotë familja), me njëfarë mënyre dëbohen nga familja”.

E përbashkëta e komuniteteve lidhur me trashëgimin e grave

Në këtë kontekst, shkëputja e marrëdhënieve me anëtarët meshkuj të familjes për shkak të ushtrimit të së drejtës së trashëgimit nga trashëgimtarët femra mund të konsiderohet si përjashtim nga familja e origjinës, çka ende sot përbën rast të turpërimit sipas grave të intervistuar nga BIRN.

Në një prononcim për KALLXO.com gjykatësi i rajonit të Prizrenit Xhemil Elshani ka shpjeguar se si është përbrendësuar e drejta zakonore në çështjen e ndarjes së pasurisë.

“Kam raste kur femrat janë deklaruar para vëllezërve se unë po i ofendoj kur u ofron të drejtë ligjore, ngase për shkak të lidhjeve të tyre tradicionale nuk dëshirojnë t’i shkëpusin marrëdhëniet familjare me prindërit, vëllezërit apo motrat”, thotë Elshani.¹⁰

Kemi raste [të heqjes dorë nga trashëgimi] për shkak të mentalitetit që mbretëron në këtë pjesë të Ballkanit”, thotë Isak Ademi, noter nga Prishtina duke shtuar se “të njëjtin mentalitet e kanë edhe popujt përreth nesh, malazezët, serbët dhe maqedonasit.”¹¹ Të dhënat grafike tregojnë se në këto vende përqindja e grave që kanë prona është më e madhe.

¹⁰ Artikulli “Sfidat e Gjykimit të Trashëgimisë” i publikuar në Kallxo.com, më 17 prill 2016 - <http://kallxo.com/sfidat-e-gjykimit-te-trashegimise/>

¹¹ Emisioni “Dorëheqja e Grave” i transmetuar në “Drejtësia në Kosovë”, më 24 qershor 2016 - <https://www.youtube.com/watch?v=ymlmzxFe71o>

Tradita islame në ndarjen trashëgimit për gratë

Shumica e popullsisë në Kosovë janë myslimanë të deklaruar.¹² Megjithatë, për qëllimet e këtij publikimi është me rëndësi të shihet si praktikë zakonore dhe krahasimi me praktikat tjera zakonore. Për shkak të karakteristikave të përmendura dhe për shkak se Islami si religjion është i vetmi që propozon sistem tjetër juridik (Sheriatin) paralel me atë kushtetues në Kosovë, është marrë në konsideratë të kësaj analize dhe do të trajtohet në nivel me të drejtën zakonore.¹³

Dy raste të mundshme

Përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) kanë sqaruar për BIRN se si ndahet trashëgimia sipas të drejtës islame.

Kurani e ka përcaktuar gruan si trashëgimtare: “Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra” (Kapitulli Nisa, 11). Ajo që duket si formë diskriminimi, sipas klerikëve, kompensohet nga një normë tjetër e cila liron gruan nga nevoja për të punuar pas martesës, çka interpretohet si arritje e barazisë brenda martesës.

Almedin Ejupi nga BIK¹⁴ e ka sqaruar këtë për BIRN: “Pavarësisht sa e pasur mund të jetë, një grua nuk është e detyruar të veprojë si bashkësiguruese për familjen, përveç nëse zgjedh me dëshirë dhe vullnet të lirë ta bëjë këtë. Bashkëshortët trashëgojnë nga njëri-tjetri.”

Po ashtu, gratë kanë të drejtë të trashëgojnë nga burrat e tyre në rast të vdekjes. “Nëse ka lënë pasardhës (djem e vajza) atëherë hisja e gruas është 1/8 e pronës së përgjithshme të burrit të vdekur. Nëse burri i saj i vdekur nuk ka lënë pasardhës atëherë gruas i takon ¼ nga prona e përgjithshme e burrit të saj.” – është shprehur Ejupi. Me pasardhës këtu kuptohen anëtarët e ngushtë të familjes; nëse flasim me gjuhën e Ligjit mbi Familjen në Kosovë, është fjala për fëmijët e trashëgimlënësit.

Ejupi ka paraqitur një skemë tipike të trashëgimit në familje sipas Islamit në dy raste hipotetike, kur trashëgimlënësi është burri dhe kur trashëgimlënësi është gruaja.

12 93% të popullsisë së Kosovës është muslimane e deklaruar http://www.thearda.com/internationaldata/countries/country_250_1.asp

13 Religjionet tjera signifikante siç është ai i krishterë (pavarësisht doktrinave) nuk mund të trajtohet në këtë analizë pasi konsiderohet si i shkrirë në modelin perëndimor përgjat një procesi të gjatë historik e sidomos prej shek XVII-XVIII kur u bënë edhe përpjekjet e mëdha të ndarjes së detyrave të shtetit me kishën si institucion në atë kohë politik.

14 Për këtë çështje është intervistuar Almedin Ejupi i caktuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në cilësinë e ekspertit të çështjeve të trashëgimit në Islam. Ai është autor i librit “E drejta trashëgimore Islame”.

Kur trashëgimlënësi është burri dhe trashëgimtarët janë gruaja, dy vajza dhe një djalë:

- a) Gruas së tij i takon $\frac{1}{8}$ e pasurisë së përgjithshme të tij, apo 12.5 %
- b) Ndërsa fëmijëve (2 vajza dhe një djalë) u takon pjesa e mbetur e pasurisë, respektivisht $\frac{7}{8}$ të cilën duhet ndarë në 4 pjesë.

Dy pjesë djalit dhe dy pjesë dy vajzave, respektivisht secilës vajzë nga një pjesë apo secilës vajzë 21.88 % ndërsa djalit 43.75 %.

Trashëgimtarët	Pjesa që i takon	Përqindja
Gruaja	$\frac{1}{8}$	12.5%
Vajza	$\frac{7}{8}$	21.88%
Vajza		21.88%
Djali		43.75%

Kur trashëgimlënësi është gruaja dhe trashëgimtarë janë burri, dy vajza dhe një djalë:

- a) Bashkëshortit i takon 25%
- b) Dy vajzave 37.50%, secilës prej tyre 18.75%
- c) Djalit 37.50%

Trashëgimtarët	Pjesa që i takon	Përqindja
Burri	$\frac{1}{4}$	25%
Vajza	$\frac{3}{4}$	18.75%
Vajza		18.75%
Djali		37.50%

Në bazë të skemave të paraqitura¹⁵ mund të vërehet se trashëgimi që i takon vajzave është sa gjysma e trashëgimit që merr djali, mirëpo në Islam kjo arsyetohet me detyrimet e burrit në familje për mbajtjen e saj.

Megjithatë, nuk ekzistojnë të dhëna faktike nga terreni mbi shkallën e zbatimit të kësaj ndarjeje të trashëgimisë sipas rregullave të së drejtës islame në Kosovë.

¹⁵ Rregullat e ndarjes në këto dy ndarje siç na bënë me dije eksperti Almedin Ejupi nuk janë fikse, prandaj ndarje të tjera janë të mundshme në vartësi të specifikave të rasteve.

Paqartësi dhe Probleme Institucionale

Në Kosovë çështja e ndarjes së pronës nga trashëgimtarët ndodh në gjykata dhe në zyrat e noterisë përmes noterëve. Të gjitha palët që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim si të intervistuar, janë pajtuar se ka një paqartësi në ligjet në fuqi. Ligji mbi Trashëgiminë Nr. 2006/26 dhe Ligji i Procedurës Jokontestimore Nr.3/L-007 me të cilin rregullohet ndarja e pronës së trashëguar mes trashëgimtarëve njohin/përmendin vetëm gjykatat si kompetente për vënien në zbatim të tyre. Në anën tjetër Ligji për Noterinë Nr.3/L-10 në Nenin 29 kur përcakton funksionet noteriale si funksion të noterisë përshkruan:

“1.4. trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore;” dhe “1.7.1. nënshkrimin dhe vulosjen e aseteve që do të ndahen në kontekst të procedurave trashëgimore dhe të falimentimit;” – pra, sipas kësaj njihet ndarja e pronës së trashëguar si funksion të noterisë.

Disa të intervistuar e kanë parë si shumë problematike këtë çështje për faktin se kjo hapësirë ligjore mund të shkaktojë probleme në të ardhmen me palët që mund të ankohen.

Fatmir Halimi, noter në Gjilan ka thënë se “Kjo kompetencë bazohet në “nenin 29 pika 1.4 ku decidivisht thotë “Trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore”.

Ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre Oda e Noterëve e arsyeton duke u thirrur në Nenin 76 i Ligjit mbi Noterinë Nr.3/L-10 cili e parasheh në dispozitat kalimtare, harmonizimin e ligjeve një apo dy vjet pas hyrjes në fuqi, i cili shprehimisht thotë:

“10. Në afat prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dorëzojnë tek Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ndryshimet në Ligjin për Trashëgimi të Kosovës dhe Ligjin për Procedurën jashtë-kontestimore, që paraqitet e nevojshme nga ky ligj.”

Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës në përgjigjen zyrtare drejtuar BIRN përmes emailit zyrtar lidhur me çështjen e infrastrukturës ligjore ka sqaruar kompetencat që dalin nga Ligji mbi Noterinë. Ky ligj i përmend vetëm gjykatat si institucione në zgjidhjen e rasteve me procedura jokontestimore. Në lidhje me këtë nga Oda e Noterëve të Kosovës kanë thënë:

«Që nga fillimi i shërbimit noterial në Republikën e Kosovës, noterët në kuadër të funksioneve të tyre, përpos funksioneve tjera ligjore të parapara me nenin 29 të Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë, si kompetencë burimore që derivon nga vetë Ligji i Noterisë, Neni 29, paragrafi 1.4 e kanë edhe të drejtën e trajtimit të të gjitha procedurave jokontestimore - trashëgimore (kur ndërmjet palëve nuk ka asnjë mosmarrëveshje), të cilën procedurë tash e katër vite noterët e trajtojnë me shumë sukses.”¹⁶

Pavarësisht kësaj, ndryshimet e parapara nuk janë bërë duke shkaktuar mbivendosje të kompetencave. Por, gjykatat dhe noterët vazhdojnë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ndarjen e trashëgimit sipas Ligjit për Procedurën Jokontestimore dhe ligjeve tjera relevante.

16 Arbena Shehu, Kryetare e Odës së Noterëve të Kosovës, 9 qershor 2016

Ministria e Drejtësisë në punë e sipër të amandamenteve

Të kontaktuar nga BIRN, zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë e kanë pranuar paqartësinë në ligj. Dafina Buçaj, këshilltare ligjore e Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë tha se “Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Noterinë është përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2016.”

Ajo ka treguar se ky ligj që do ta amandantojë Ligjin për Noterinë do ta shmangë paqartësinë në interpretim të ligjit si dhe mbivendosjen me dispozitat e ligjeve tjera.

“Projektligji për Noterinë ka kaluar të gjitha fazat e konsultimeve paraprake dhe me publikun dhe për momentin Ministria e Drejtësisë është në fazën e analizimit të komenteve të pranuar gjatë kësaj periudhe dhe adresimit të tyre në projektligj” tha Buçaj për BIRN.

Kohëgjatësia e procedurave si pengesë për realizim simbolik të së drejtës

Një nga format e diskutuara gjatë fokus grupit me gratë aktiviste ka qenë mundësia që e drejta e trashëgimit fillimisht të ushtrohet e pastaj pronësia të kalohet te trashëgimtarët meshkuj si dhuratë, me qëllim të shënimit simbolik të së drejtës fillimisht dhe me qëllim të kalimit të ngadaltë nga një frymë kulturore e vjetëruar në një tjetër në përputhje me ligjet dhe frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gratë aktiviste të moshave të shtyra kanë menduar se kjo mund të jetë zgjidhja për rastet e tyre. Siç u tha më lart, një numër i grave (më në moshë) i kanë të përbendësuar vlerat tradicionale dhe shpërputhja e atyre vlerave me ligjin mund të gjejë mirëkuptim në këtë ushtrim simbolik të së drejtës, duke e parë këtë si të rëndësishëm në edukimin e gjeneratave pasardhëse.

Mirëpo argument kundër i shtruar prej tyre ka qenë kohëzgjatja e procedurave të kalimit të pronës nga trashëgimlënësi te trashëgimtarët si dhe shpenzimet që mund të krijojnë ato (vetëm në rastet kur bëhet fjalë për trashëgim prone apo pasurie).

Për pleqnarin nga Juniku, Adem Hoxha, i cili ishte intervistuar nga Drejtësia në Kosovë, problemet në zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe të trashëgimit te gratë lidhen me mos funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, i cili sipas tij zvarrit zgjidhjen e kontesteve pronësore. Sipas Hoxhës, në praktikë, problematike është vetëdija e grave dhe vajzave të cilat hezitojnë të kërkojnë nga familja e tyre pronën që ju takon. “Mentaliteti tek ne sa i përket çështjes së trashëgimisë mund të ndryshojë nëse qytetarëve ju shpjegohen të drejtat e tyre ligjore si dhe nëse gjykatat tregohen më ekspeditive dhe më efikase në zgjidhjen e këtyre rasteve” – tha Hoxha.¹⁷

Një numër i madh i të dhënave nga gjykatat duhet të bëhen përgjatë procesit gjyqësor. Mungesa e databazve elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve të cilat do t'i evitonin mashtrimet dhe nevojën për verifikim veç e veç të shumë dokumenteve, ndikon në tejzgjatjen e proceseve.

17 Emisioni “Ligji i Trashëgimisë” transmetuar në “Drejtësia në Kosovë” më 27 maj 2016: <http://kallxo.com/dnk/ligji-i-trashegimise/>

Pala propozuese për ndarjen e trashëgimisë gjatë procedurës jokontestimore duhet të sjellë dëshmi që i kërkohen nga gjykata në mënyrë që të përgatitet dëshmia mbi vdekjen. Po ashtu, sipas rasteve, gjykata mund të shtrojë kërkesa sipas detyrës zyrtare me qëllim të verifikimit të saktë në rastet kur dëshmitë e sjella nga pala propozuese për ndarjen e trashëgimisë nuk janë të bollshme. Kjo ndodh për shkak se pasojat juridike që mund të vijnë si pasojë e gabimeve janë të rënda për palët me interes.

Kjo është edhe një nga arsytet që ka bërë që proceset të jenë më të gjata sesa është dashur të jenë.

Ndërkaq te noteri kjo procedurë duket të jetë më e shpejtë dhe më efektive për shkak se është në interesin e noterëve që t'i kryejnë lëndët, pasi kështu edhe gjenerojnë përfitim për veprimtarinë që ushtrojnë.

Përshejtimi i procedurave është në favor të ndarjes së shpejtë të trashëgimit që mund t'u takojë grave trashëgimtare.

Krahasim i shkurtër i kornizave ligjore Kosovë-Shqipëri-Maqedoni

Duke qenë se Kosova qëndron më së keqi në numrin e grave të regjistruara si pronare në raport me vendet fqinje dhe duke pasur parasysh madhësinë për nga numri i banorëve të ngjashëm me Shqipërinë dhe Maqedoninë, është bërë një krahasim i shkurtër i kornizave ligjore të këtyre vendeve me Kosovën.

Cili institucion e kryen ndarjen e trashëgimit?

Në Shqipëri kjo çështje është zgjidhur në Kodin Civil¹⁸ ku noteri është paraparë ta kryejë funksionin e ndarjes së pronës së trashëguar. Ngjashëm dhe në Maqedoni këtë funksion e kryen noteri, pasi trashëgimlënësi të ketë vdekur me ç'rast gjykata cakton rastin te noteri përkatës sipas ndarjes territoriale¹⁹. Ndërkaq në Kosovë, siç është thënë më lart, gjatë këtij publikimi, ka interpretime të ndryshme lidhur me atë se kush duhet ta kryejë funksionin e ndarjes së trashëgimit.

Cili është rendi i trashëgimtarëve?

Rendi i trashëgimtarëve është i njëjtë në të tria rastet. Në radhën e parë ndodhen bashkëshorti/ja dhe fëmijët pa dallime gjinore.

18 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë: [http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi Civil.pdf](http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20Civil.pdf)

19 Intervistë e Presidentës së Noterëve të Maqedonisë Zorica Pulejkova për Fondacionin Italian të Noterisë <http://elibrary.fondacionenotariato.it/articolo.asp?art=39/3947&mn=3>

Si trashëgohet?

Në të tria rastet trashëgimia bëhet e mundshme sipas ligjit me procedura të rregullta ligjore pas propozimit të trashëgimtarëve dhe me testament.

A lejohet heqja dorë nga trashëgimi?

Heqja dorë nga trashëgimia është paraparë në të tria rastet. Edhe në Shqipëri edhe në Kosovë edhe në Maqedoni është mundësuar heqja dorë nga trashëgimia.

Në të gjitha rastet përcaktimet ligjore janë pak a shumë të ngjashme, por bazuar në raportin e EULEX-it, Kosova qëndron më së keqi në rajon sa i përket posedimit të pronave nga pronarët femra me 16%. Krahasuar me shtetet me të cilat kufizohet, përfshirë Maqedoninë dhe Shqipërinë, Kosova qëndron në vendin e fundit të posedimit të pronave nga pronarët femra. E parafundit është Maqedonia me rreth 17-18% të posedimit të pronave nga pronarët femra, ndërsa Shqipëria ka një përqindje rreth 27% të posedimit të pronave nga pronarët femra.²⁰

Krahasim i shkurtër i kornizave ligjore Kroaci-Slloveni-Kosovë

Duke qenë se Kosova aspiron integrimin në BE është parë e arsyeshme të bëhet një krahasim i shkurtër i kornizës ligjore të Kosovës me kornizat ligjore të Kroacisë dhe Sllovenisë si vende që bashkë me Kosovën kanë qenë pjesë e një fryme kushtetuese në periudhën jugosllave dhe që tashmë janë pjesë e BE-së.

Cili institucion e kryen ndarjen e trashëgimit?

Në të gjithë Bashkimin Evropian çështja e ndarjes së trashëgimisë kryhet te noteri përveç Sllovenisë dhe Bullgarisë, të cilat këtë çështje ende e kryejnë në gjykata.²¹ Në Kroaci gjykata dorëzon dosjen te noteria përkatëse sapo ta ketë marrë certifikatën e vdekjes, ngjashëm si në rastin e Maqedonisë.

²⁰ Monitoruesit mobilë – EULEX Kosova “Women And Inheritance Rights to Real Estate in Kosovo”, tremujori i parë i vitit 2016, faqe 5.

²¹ Rrjeti i Noterëve të Evropës, tetor 24, Maribor (Slloveni) https://www.enr-online.eu/fileadmin/user_upload/SL_workshop-Full_Report_including_evaluation_summary.pdf

Cili është rendi i trashëgimtarëve?

Për sa i përket rendit të trashëgimtarëve në Kroaci dhe Slloveni, ashtu si në Kosovë bashkëshorti/ja dhe fëmijët janë në rendin e parë. Për dallim nga Sllovenia dhe Kosova që ndarjen e trashëgimit e rregullojnë si të barabartë mes trashëgimtarëve (bashkëshortit/es dhe fëmijëve), në Kroaci bashkëshorti/ja përfiton në varësi të detyrimeve të ndërsjellta martesore të përcaktuara më parë me lidhjen e martesës.

Si trashëgohet?

Në të tria rastet trashëgimia bëhet e mundshme sipas ligjit me procedura të rregullta ligjore, pas propozimit të trashëgimtarëve dhe me testament.

A lejohet heqja dorë nga trashëgimi?

Heqja dorë nga trashëgimia është dispozitë që po ashtu zbatohet në Kroaci dhe Slloveni.

Rasti i Shyhrete Berishës

Edhe pse fokusi i këtij publikimi ka qenë shqyrtimi i marrjes së trashëgimit kryesisht në raste jokontestimore, duhet të përmendet rasti i Shyhrete Berishës si një rast me potencial për vënien e precedentit juridik në Republikën e Kosovës.

Shyhrete Berisha është shtetase e Kosovës nga Suhareka ku ka jetuar deri në vitin 1999 kur gjatë luftës, familja e saj u masakrua më 26 mars nga forcat ushtarake serbe.

Shyhrete Berisha ka akuzuar kunatin e saj (vëllain e burrit të vrarë) Xhelal Berisha se ia ka marrë të drejtat që i takojnë me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Trashëgiminë, raportuar edhe nga KALLXO.com.

Kunati i saj ka pretenduar se ai është trashëgimtar i shtëpisë ku znj. Berisha ka jetuar me bashkëshortin dhe fëmijët e saj për shkak se ajo nuk ka qenë e ndarë paraprakisht mes trashëgimtarëve të babait të burrit të znj. Berisha.

Avokati i saj poashtu ka kërkuar që t'i jepet e drejta bazuar edhe në kontributin që ajo ka dhënë gjatë jetesës së saj në atë shtëpi deri në vitin 1999 me bashkëshortin dhe fëmijët e saj.²²

Pas ofertës së refuzuar nga Shyhrete Berisha për t'i blerë asaj një banesë, ka pasuar ofertë tjetër për shfrytëzim të përhershëm të pronës. Avokati i znj. Berisha e ka refuzuar në emër të saj pronën.

²² Artikulli i botuar në Kallxo.com "Shyhrete Berisha kërkon shtëpinë edhe në bazë të kontributit" më 18 qershor 2016 <http://kallxo.com/shyhrete-berisha-kerkon-shtepine-edhe-ne-baze-te-kontributit/>

Avokatja e palës së paditur ka thënë se bazuar në ligj asaj nuk i takon kjo pronë, dhe se ajo u takon vetëm fëmijëve të saj (të cilët i ishin vrrarë në luftë znj. Berisha). “E drejta e resë për ta trashëguar pronën e vjehrrit nuk parashihet me ligj. Këtë të drejtë e kanë vetëm fëmijët e saj”, është shprehur avokatja e Xhelal Berishës.²³

Mirëpo Ligji për Trashëgiminë dhe Ligji Mbi Familjen i japin të drejtë znj. Berisha për të trashëguar bashkëshortin e saj dhe fëmijët e saj.

Në komunikim zyrtar me avokatin Naim Qelaj, BIRN ka marrë mendimin e tij për sa i përket sfidës më të madhe që i është paraqitur rastit të Shyhrete Berishës në procesin gjyqësor.

“Problem kryesor në këtë rast e kam parë ligjin, mostrajtimin e barabartë të gruas dhe burrit. Ka të bëjë me të drejtën e përfaqësimit në nenin 13 [Ligji për Trashëgiminë i Kosovës]. Kur vdes fëmija i trashëgimlënësit thotë se trashëgohet vetëm nga të paslindurit, pra gruan e përjashton” – tha avokati Qelaj për BIRN.

Mirëpo Kushtetuta e Kosovës e garanton barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi. Për këtë është shprehur i gatshëm edhe avokati Qelaj i cili ka thënë se nëse i duhet rastin do ta çojë deri në Gjykatën Kushtetuese: “Nëse duhet unë shkoj edhe deri në Gjykatë Kushtetuese dhe besoj se ata do të japin qëndrim të drejtë në këtë punë”.

Për rastin nuk është vendosur ende por ai është parë nga mediet dhe shoqëria civile si një precedent në drejtësinë Kosovare për sa i përket të drejtave të grave në trashëgim të pronës në lidhje martesore.

Me vendosjen e këtij rasti në favor të znj. Berisha do të shuheshin mundësitë e ambiguitetit interpretues te rendi i trashëgimtarëve qoftë edhe në rastet e mungesës së lidhjes së martesës apo të ngjashme.

Ngjashëm me këtë rast ka qenë rasti i Shukrie Berishës, e cila paditi kunatin e saj në vitin 2005 pasi ai e kishte kaluar tërë pronën e trashëguar nga babai në emrin e tij. Kështu ai kishte anashkaluar Shukrie Berishën e cila kishte jetuar 30 vjet në shtëpinë e përmendur me burrin e saj që kishte ndërruar jetë para se të bëhej ndarja e pronës mes trashëgimtarëve. Ajo pretendonte se ka të drejtë ta trashëgojë një pjesë të shtëpisë.²⁴

Pas 11 vitesh, aq sa është dashur që gjykimi të marrë formën e prerë, asaj i është ndarë 1/10 e oborrit dhe 1/6 e shtëpisë ku ajo ka kontribuar 30 vjet sa ka jetuar në të me burrin e saj.

A trashëgojnë personat që bashkëjetojnë në bashkësinë jashtmartesore?

Ligji për Trashëgiminë në Kosovë e parashihet trashëgiminë e bashkëshortëve pa lidhje të martesës në dy raste.

²³ Artikulli i botuar në Kallxo.com “Xhelal Berisha me ofertë të re për Shyhrete Berishën”, më 9 dhjetor 2014 <http://kallxo.com/xhelal-berisha-me-oferte-te-re-per-shyhrete-berishen/>

²⁴ Emisioni “Drejtësia e Vonuar” transmetuar në “Drejtësia në Kosovë” më 6 qershor 2016 <https://www.youtube.com/watch?v=5sEf-5B0-N8>

Në Nenin 28.1, në pikën a thuhet:

“Burri dhe gruaja që bashkëjetojnë në një bashkësi jashtëmartesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse:

a. Bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrdhënie kanë lindur fëmijë - të paktën 5 vjet”

Pra sipas Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë në rastet e bashkëjetesës për 10 vjet, apo në rastet kur ka fëmijë deri në 5 vjet, bashkëshortët fitojnë të drejta në trashëgim.

Megjithatë në Nenin 28.2, kontestohet domosdoshmëria e trashëgimit të personit në bashkësi jashtëmartesore:

“Personat që kanë bashkëjetuar nuk konsiderohen si trashëgimtar të domosdoshëm.”

Konkludime

Gratë në Kosovë posedojnë vetëm 16% të pasurive të paluajtshme si rrjedhojë e moszbatimit të ligjit në maksimumin e mundësive të tij. Kjo do të thotë se heqja dorë nga e drejta e trashëgimit luan rol të rëndësishëm në përkeqësimin e gjendjes kur vjen fjala te ndarja në përqindje e pronarëve meshkuj dhe femra të patundshmërive në Kosovë.

Ka mbivendosje kompetencash dhe paqartësi ligjore në funksionimin e gjykatave dhe sistemit noterial të Kosovës si pasojë e mos-harmonizimit të ligjeve në fuqi që rregullojnë çështjet e trashëgimit të pronave nga trashëgimtarët. Këto probleme në legjislacion përbëjnë pengesa reale për zgjidhjen e rasteve të trashëgimisë në Kosovë.

Mungon baza elektronike e të dhënave që do ta përshpejtonte çdo procedurë të realizimit të trashëgimit dhe do ta minimizonte mundësinë e deklarimeve të rrejshme apo mashtrimeve të natyrave të ndryshme.

Mundësia e marrëveshjes mes palëve dhe mundësia për të hequr dorë nga e drejta e trashëgimit ka rezultuar kryesisht me heqjen dorë të grave nga e drejta e trashëgimit për arsye të ndryshme që lidhen me mentalitetin patriarkal të shoqërisë kosovare.

Diskursi kosovar është i ngarkuar me koncepte patriarkale kur vjen puna te trashëgimi i pronës. Gratë e konsiderojnë pjesën që u takon në trashëgim si pjesë që duhet “marrë” nga trashëgimtarët meshkuj dhe kjo shkakton pamundësinë e funksionimit normal të ligjeve, pasi ato zëvendësohen me tradita popullore.

Rekomandime

Lidhur me kornizën ligjore

- Të kryhen harmonizimet e ligjeve dhe t'i kalohet kompetenca e zhvillimit të procedurës jokontestimore lidhur me trashëgimin noterisë.
- Gjykatat ta kryejnë vetëm iniciimin e procedurave pranë noterive sipas territorit të pronës që do të trashëgohet apo ngjashëm, me qëllim që të eliminohen mundësitë e manipulimeve nga agjencitë e patundshmërive.
- Të hyjë në funksion baza elektronike e të dhënave me ç'rast dëshmia mbi vdekjen dhe përcaktimi i trashëgimtarëve në fillim të procesit të ndarjes së trashëgimit të mos varet nga deklaratat (që potencialisht mund të rezultojnë të rrejshme) të inicuesve të procedurave, por të jenë automatike e me mundësi ndryshimi gjatë procesit apo në fund të tij në rast të nevojës.
- T'u krijohet qasje e drejtëpërdrejtë dhe e kontrolluar gjykatësve dhe noterëve në bazën e regjistrit të gjendjes civile.
- Të ndiqet praktika e disa vendeve të rajonit dhe të BE-së për sa i përket trashëgimit nga bashkëshortët. Pjesa e trashëgimit të tyre të mos jetë e barabartë me trashëgimtarët e tjerë, por t'i shtohet edhe pjesa që u takon duke llogaritur kontributin e tyre në krijimin e pasurisë, duke konsideruar edhe amvisërinë si kontribut.
- Të amandamentohet neni 13 i Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë i cili në rast të vdekjes së fëmijës trashëgimtar para trashëgimlënësit, trashëgohet nga fëmijët e tij. Në këtë nen duhet të shtohet edhe bashkëshorti/ja.
- Të hetohen me prioritet rastet e falsifikimit dhe mashtrimit gjatë zgjidhjes së trashëgimisë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës të nxjerrë qëndrim që zgjidhjen e kontesteve martesore dhe të trashëgimisë, sidomos tek rastet e dhunës në familje, të hyjnë në mesin e lëndëve prioritare në gjykatat e vendit.

Lidhur me emancipimin shoqëror

Procesi i amandamentimit të ligjeve të noterisë, trashëgimisë dhe atij për procedurën jokontestimore të jenë gjithpërfshirës dhe të shoqërohen me një fushatë vetëdijësuese.

- Të nxitet debat shoqëror nga shoqëria civile dhe njësitet për te Drejtat e Njeriut në kuadër të komunave me qëllim të informimit të qytetarëve, konkretisht grave për të drejtën e tyre në trashëgim – debati të ketë pronësi lokale, jo ndërkombëtare.
- Ministria e Arsimit të fusë në kurrikulat e arsimit fillor dhe të mesëm informacione shtesë për të drejtat e grave në trashëgim dhe ta luftojë aktivisht diskursin patriarkal si në rastet e librave shkollorë a universitarë, kur trashëgimi shihet sipas të drejtës zakonore apo ngjashëm me të.
- Të bëhet nxitja e personave me ndikim publik që të nisin një fushatë të koordinuar për të diskutuar për këto çështje në medie ashtu që të nxitet një vetëdijësim në masë lidhur me këtë çështje.
- Të synohet krijimi i shembujve pozitivë të grave me ndikim publik të cilat flasin hapur për realizimin e së drejtës së tyre në trashëgim.
- Fjala trashëgim të mos përzihet me fjalën trashëgimi në gjuhën shqipe. Fjala trashëgimi është fjala që përshkruan një send a kualitet kulturor si pasuri shoqërore (në anglisht 'heritage'). Fjala trashëgim shenjon pronë ose objekt të trashëguar nga trashëgimtari (në anglisht 'inheritance'). Në raport me këtë të amandamentohet edhe emri i Ligjit për Trashëgiminë.

Referenca

Joierman. S. (2015). Heqje dorë nga të drejtat? Pengesat në pronësinë e grave në Kosovë. Marrë nga <http://scholarship.richmond.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1056&context=polisci-faculty-publications>

Mundësitë ekonomike dhe të pronës në Kosovë. (Janar, 2015). Marrë nga https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/Kosovo%20PRP%20Report_Gender%20Property%20and%20Economic%20Opportunity%20in%20Kosovo_ENG....pdf

Kodi Civil i Republikës Së Shqipërisë. (18 prill, 2013). Marrë nga <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20Civil.pdf>

Ligji për Tashëgiminë në Kosovë Nr. 2004/26 (1 gusht, 2006). Marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>

Profillet kombëtare, grupet më të mëdha fetare – Kosova (2015). Marrë nga http://www.thearda.com/internationaldata/countries/country_250_1.asp

Ligji evropian i suksesionit: trashëgimi dhe taksa e trashëgimit. (2014). Marrë nga <https://www.cesifo-group.de/ifoHome/facts/DICE/Public-Sector/Public-Finance/Taxes/Succession-law-in-Europe-inheritance-tax/fileBinary/Succession-law-in-Europe-inheritance-tax.pdf>

Projekti mbi palujtshmërinë dhe kadastrin – përmbledhje e kënaqshmërisë vjetore të konsumatorit (prill, 2014). Retrieved from <http://www.kca-ks.org/documents/10179/319567/ang.pdf/3f4bf6ff-7ba4-46ee-8d17-b0e0cb3d7a2d>

Të intervistuarit

Abdullah Aliu - Profesor në UP i të drejtës së trashëgimisë

Adem Berisha - I paditur për çështje të trashëgimisë

Adile Shaqiri - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Albana Kelmendi – Avokate

Alije Ashiku – I paditur për çështje të trashëgimisë

Almedin Ejupi – Ekspert i çështjeve të trashëgimisë sipas të Drejtës Islame

Antigona Uka - Zyrtare e Gjykatës Supreme në Prishtinë

Arbena Shehu – Kryetare e Odes së Noterëve të Kosovës

Asdren Hoxha – Avokat

Avdyl Hoxha – Pleqnar

Behije Zajmi - Zyrtare e Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës

Besa Veseli – Zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Mitrovicës

Drita Milaku – Asambleiste në Komunën e Prizrenit

Drita Rexha – Gjyqtare në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Durim Osmani – Avokat

Elbasan Dervishaj – Udhëheqës i Departamentit për Profesione të Lira, Ministria e Drejtësisë

Enver Peci - ish Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Fatmir Halimi – Noter

Faton Bajrami - Gjyqtar

Feraseta Alija Pejqinoviç - Notere

Hajrie Aliu - Palë e dëmtuar

Hamdi Podovorica – Profesor i së drejtës së trashëgimisë në Fakultetin Juridik – Universiteti i Prishtinës

Ilaz Berisha – I paditur për çështje të trashëgimisë

Isa Mehaj - Qytetar

Isa Salihu – Avokat

Isak Ademi - Noter

Jakup Haxhiu - Shef i personelit në komunën e Vitisë

Kelmend Rexhepi - Zyrtar financiar në komunën e Kllokotit

Kushtrim Kaloshi - Drejtor ekzekutiv, ATRC

Lirije Kajtazi - Deputete e Kuvendit të Kosovës

Luljeta Demolli - Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës për Studime dhe Barazi Gjinore

Majlinda Ortoçllava – Asamblete në Komunën e Vushtrrisë

Melihate Osmani - Drejtoreshë e organizates jo qeveritare “Legjenda” në Viti

Mevlide Shabani - Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan

Miradie Gashi Sheremeti - Drejtoreshë në Organizatën Joqeveritare “Venera”

Mirlinda Tishuku-Sadiku - Asamblete në Kuvendin Komunal në Viti

N.N. Viktimë e larguar nga Shtëpia

Naim Qelaj – Avokat

Nita Lusha – SOS fshati Prishtinë

Prenk Pepaj – Avokat

Qëndresa Hajdare – “Gruaja Hyjnore” Gjilan

Rabishe Mazreku - Palë e dëmtuar

Ramë Dreshaj – Avokat

Safet Voca - Avokat nga Mitrovica

Sanije Jahiri - Drejtoreshë e organizates jo qeveritare “Fortesa” në Kamenicë

Sanja Sovrlic - gazetare e TV “Mir”

Sefadin Blakaj – Profesor i së drejtës së detyrimeve në Universitetin e Prishtinës dhe noter

Selvije Fetahu - E paditur për çështje të trashëgimisë

Shaban Zeqirja – Gjykatës

Shaqir Vula – Noter

Shefki Syla - Avokat

Shkodran Ramadani - Sociolog

Shpresa Veliqi – asamblete në Komunën e Skënderajt

Shukrije Berisha – Palë paditëse

Teki Bokshi – Avokat nga Gjakova

Teuta Zhinipotoku – Avokate

Valbona Doli-Rizvanolli - Drejtoresha e OJQ-së “Femrat Aktive të Gjakovës”

Valdete Fetahu – I paditur për çështje të trashëgimisë

Veton Rrecaj – Avokat

Violeta Berisha – zyrtare e Departamentit për Integrim në MPB

Vjollca Kadolli - Asamblete në kuvendin komunal në Viti

Xhemil Elshani – Gjykatës

Xhevrije Peci – Këshilltare për persona me aftësi të kufizuar në Prishtinë.

Zenel Hasanaj - Zyrtar ligjor nga Zyra për ndihmë juridike falas

Zenel Leku – Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Ziza Mehaj - Qytetare Ankuese

PËRKRAHUR NGA:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



E DREJTA E TRASHËGIMIT NË PRONË E GRAVE TË KOSOVËS

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN (Kosovë)

"Mensa e Studenteve" 1st Floor,
Prishtina 10 000, Kosovo

Website: www.kosovo.birn.eu.com

Email: kosova@birn.eu.com

Design by: project.GRAPHICS